



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 709/4 prot.

Elbasan, me 20.03.2025

VENDIM

Nr. 10 datë 20.03.2025

Për pagesën e orëve suplementare të vitit akademik 2024-2025

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", Vendimit të Senatit Akademik nr. 32, datë 17.03.2025, "Për pagesën e orëve suplementare të vitit akademik 2024-2025", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë t'i paguhet deri në 300 orë suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës në auditor për vitin akademik 2024-2025, pasi të ketë përmbushur kohën minimale vjetore të punës prej 1,536 orë.
2. Fondi për këtë pagesë të përballohet nga granti i parashikuar për shpenzimet e pagave të punonjësve për vitin 2025.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durmishi

